



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E SHITES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim
Uprava za Obrazovanje/Department of Education

Data	2 korrik 2026
Nr	05/480
Për	Kuvendin e Komunës së Shtimes
Përmes	z. Qemajl Aliu, kryetar i Komunës së Shtimes
Nga	Lulzim Sahiti, udhëheqës i Sektorit të Arsimit
Lënda	Informatë për përfundimin e vitit mësimor dhe suksesin e nxënësve në arsimin parauniversitar

Hyrje

Meqenëse në mbledhjen e -V- të rregullt të Kuvendit të Komunës së Shtimes, të mbajtur më 26. 6. 2026 jeni informuar lidhur me punën e ekzekutivit, ku bënë pjesë edhe Drejtoria Komunale e Arsimit, për këtë seancë kemi përgatitur një informatë të detajuar për përfundimin e vitit mësimor dhe suksesin e nxënësve në arsimin parauniversitar.

Në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, bëjnë pjesë gjithsej 7 shkolla amë me 9 paralele të ndara fizike, ku mësimin, në vitin shkollor 2025/26, e kanë vijuar 3124 nxënës, të shpërndarë në 190 paralele, që i bie mesatarisht 16.44 nxënës për paralele, prej tyre: Në nivelin e arsimit fillor, I-V, janë 1663 nxënës, të shpërndarë në 110 paralele, mesatarisht 15.11 nxënës për paralele, ndërsa në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, VI-IX, janë gjithsej 1461 nxënës, të shpërndarë në 80 paralele, mesatarisht 18.26 nxënës për paralele.

Ndërkaq, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, X-XII, janë gjithsej 787 nxënës, të shpërndarë në 42 paralele, mesatarisht 18.73 nxënës për paralele.

Suksesi i nxënësve në nivelin e parë të arsimit (I-V)

Në nivelin fillor të arsimit, kalueshmëria e nxënësve është: 1609 nxënës me sukses pozitiv ose 97.44 për qind, 31 me sukses të pamjaftueshëm ose 0.85 për qind dhe 23 nxënës të panotuar ose 1.71 për qind, gjegjësisht:

- Me sukses të shkëlqyeshëm janë: 933 nxënës ose 52.37 për qind
- Me sukses shumë të mirë janë: 344 nxënës ose 23.32 për qind
- Me sukses të mirë janë: 238 nxënës ose 14.78 për qind

- Me sukses të mjaftueshëm janë: 94 nxënës ose 6.97 për qind
- Me sukses të pamjaftueshëm janë: 31 nxënës ose 0.85 për qind
- Të panotuar janë: 23 nxënës ose 1.71 për qind

Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2025/26 – Niveli e arsimit fillor (I-V)

Emri i shkollës		Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve			Kaluan klasën me sukses								Përcillen		Të pa notuar		Gjithsej orë gjatë vitit		
						Shëlqyeshëm		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative				Të planifikuara	Të mbajtura	Nota mesatare
M	F	GJ	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%						
1	"A. Shabani"	10	58	52	110	46	41.82	26	23.64	20	18.18	12	10.91	0	00	6	5.45	8363	8232	4.06
2	"B. Curri"	15	99	99	198	107	54.04	40	20.20	34	17.17	16	8.08	1	0.51	0	00	6739	6681	4.25
3	"E. Duraku"	40	412	347	759	448	59.03	142	18.71	105	13.83	29	3.82	25	3.29	10	1.32	18616	18453	4.2
4	"H. Prishtina"	10	84	74	158	74	46.84	42	26.58	23	14.56	13	8.23	1	0.63	5	3.16	1050	1035	4.09
5	"I. Ajeti"	5	38	44	82	45	54.88	26	31.71	7	8.54	4	4.88	0	00	0	00	4119	4091	4.20
6	"L. Poradeci"	25	144	115	259	170	65.64	43	16.60	30	11.58	12	4.63	4	1.54	0	00	8932	8886	4.38
7	"Skënderbeu"	5	62	35	97	43	44.33	25	25.77	19	19.59	8	8.25	0	00	2	2.06	2408	2386	4.08
Gjithsej:		110	897	766	1663	933	52.37	344	23.32	238	14.78	94	6.97	31	0.85	23	1.71	50227	49764	4.18

Suksesi i nxënësve në nivelin e dytë të arsimit (VI-IX)

Në nivelin mesëm të ulët të arsimit, kalueshmëria e nxënësve është: **1309** nxënës me sukses pozitiv ose **92.07** për qind, **127** me sukses të pamjaftueshëm ose **6.63** për qind dhe **25** nxënës të panotuar ose **1.30** për qind, gjegjësisht:

- Me sukses të shkëlqyeshëm janë: 375 nxënës ose 27.66 për qind
- Me sukses shumë të mirë janë: 299 nxënës ose 23.62 për qind
- Me sukses të mirë janë: 366 nxënës ose 24.57 për qind
- Me sukses të mjaftueshëm janë: 269 nxënës ose 16.22 për qind
- Me sukses të pamjaftueshëm janë: 127 nxënës ose 6.63 për qind
- Të panotuar janë: 25 nxënës ose 1.30 për qind

Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2025/26 – Niveli i arsimit të mesëm të ulët (VI-IX)

Emri i shkollës		Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve			Kaluan klasën me sukses								Kanë përsëritur klasën		Të pa notuar		Gjithsej orë gjatë vitit		Nota mesatare
						Shëlqyeshëm		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative				Të planifikuara	Të mbajtura	
			M	F	GJ	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
1	"A. Shabani"	8	40	44	84	30	35.71	18	21.43	20	23.81	15	17.86	0	00	1	1.19	7403	7309	3.78
2	"B. Curri"	12	91	93	184	40	21.74	44	23.91	48	26.09	36	19.57	16	8.70	0	00	7107	6714	3.35
3	"E. Duraku"	28	309	335	644	136	21.12	100	15.53	170	26.40	145	22.52	76	11.80	17	2.64	17073	15758	3.18
4	"H. Prishtina"	8	86	71	157	24	15.29	32	20.38	43	27.38	28	17.83	25	15.92	5	3.18	4784	4491	3.1
5	"I. Ajeti"	4	40	36	76	19	25.00	26	34.21	21	27.63	5	6.58	5	6.58	0	00	4295	4087	3.70
6	"L. Poradeci"	16	119	100	219	96	43.84	55	25.11	44	20.09	21	9.59	3	1.37	0	00	7520	7357	3.79
7	"Skënderbeu"	4	49	48	97	30	30.93	24	24.74	20	20.62	19	19.59	2	2.06	2	2.06	2371	2289	3.64
Gjithsej:		80	734	727	1461	375	27.66	299	23.62	366	24.57	269	16.22	127	6.63	25	1.30	50553	48005	3.51

Suksesi i nxënësve në nivelin e tretë të arsimit (X-XII), përkatësisht në Gjimnazin “Naim Frashëri” dhe në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Shtime

Në nivelin mesëm të lartë të arsimit, kalueshmëria e nxënësve është: **684** nxënës me sukses pozitiv ose **87.14** për qind, **78** me sukses të pamjaftueshëm ose **9.57** për qind dhe **25** nxënës të panotuar ose **3.30** për qind, gjegjësisht:

- Me sukses të shkëlqyeshëm janë: 119 nxënës ose 15.04 për qind
- Me sukses shumë të mirë janë: 165 nxënës ose 20.67 për qind
- Me sukses të mirë janë: 231 nxënës ose 29.36 për qind
- Me sukses të mjaftueshëm janë: 169 nxënës ose 22.07 për qind
- Me sukses të pamjaftueshëm janë: 78 nxënës ose 9.57 për qind
- Të panotuar janë: 25 nxënës ose 3.30 për qind

Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2025/26 – Niveli i arsimit të mesëm të lartë (X-XII)

Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2023/20 – Niveli i parshmit të mesimit të lartë (X-XII)																				
Emri i shkollës		Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve			Kaluan klasën me sukses								Kanë përsëritur klasën		Të pa notuar		Gjithsej orë gjatë vitit		Nota mesatare
						Shëlqyeshëm		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative				Të planifikuara	Të mbajtura	
			M	F	GJ	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			Nr	%			
1	“N. Frashëri”	21	172	242	414	69	16.67	109	26.33	121	29.23	44	10.63	67	16.18	4	0.97	11466	10244	3.39
2	IAAP,	21	211	162	373	50	13.40	56	15.01	110	29.49	125	33.51	11	2.95	21	5.63	11729	11541	2.52
Gjithsej:		42	383	404	787	119	15.04	165	20.67	231	29.36	169	22.07	78	9.57	25	3.30	23195	21785	2.90

Vlerësim i jashtëm i nxënësve

Qendra për Vlerësim që vepron në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me DKA-në bëjnë organizimin e përvitshëm të vlerësimit të jashtëm të nxënësve.

Provimi i Maturës Shtetërore 2026

Më **20 qershor 2026**, në dy qendra të testimit, përkatësisht në ambientet e Shkollës së Mesme të Ulët “Emin Duraku” dhe në Institucionin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Shtime, është mbajtur Testi i Maturës Shtetërore 2026. Në afatin e parë të këtij procesi, nga Komuna e Shtimes testit të maturës i janë nënshtruar gjithsej 230 nxënës, të cilët kanë qenë të shpërndarë në dy qendra të testimit.

Procesi i organizimit dhe zhvillimit të testimit është realizuar sipas planifikimeve të përcaktuara, ndërsa mbarëvajtja e tij është mbikëqyrur nga administrues të angazhuar nga Komuna e Ferizajt, si dhe nga anëtarë të komisionit përkatës nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Gjatë gjithë procesit është synuar krijimi i kushteve të barabarta dhe një ambienti të përshtatshëm për të gjithë kandidatët.

Testi i Maturës Shtetërore është zhvilluar brenda një dite të vetme për të gjithë maturantët dhe ka përfshirë gjithsej 100 kërkesa, të ndara në katër fusha kryesore. Kandidatët janë testuar në gjuhën amtare, gjuhën angleze, matematikë, si dhe në një lëndë zgjedhore të përcaktuar nga vetë nxënësit, me nga 25 kërkesa për secilën lëndë. Rezultatet janë publikuar më 29 qershor nga Ministria e Arsimit dhe Teknologjisë.

Rezultatet e Testit të Maturës – Qershor 2026 në Gjimnazin “N. Frashëri”

Drejtimi	Nxënës që kanë hyrë në provim	Nxënës që kanë kaluar testin	Përqindja e kalueshmërisë
Gjimnaz i Shkencave Natyrore	76	57	75.00 %
Gjimnaz i Shkencave Shoqërore	64	27	42.18 %
Gjithsej	140	84	60.00 %

Krahasuar me rezultatet e vitit paraprak, kemi një ngritje solide prej 5.52 për qind.

Rezultati i Testit të Maturës 2026 (afati i Qeshorit) në formë tabelare në IAAP në Shtime

	Drejtimi	Nx. që kanë hyrë në provim	Nx. që kanë kaluar testin	Përqindja e kalueshmërisë
Shkolla Profesionale (I)	Bujqësi	4	0	0.00 %
Shkolla Profesionale (II)	Elektroteknikë	1	0	0.00 %
	Makineri	6	1	16.67 %
Shkolla Profesionale (III)	Ekonomi	31	6	19.35 %
	Administratë	11	4	36.36 %
	Ndërtimtari	9	2	22.22 %
	Shëndetësi	28	20	71.43 %
Gjithsej:		90	33	36.67 %

Krahasuar me rezultatet e vitit paraprak, kemi një ngritje shumë të vogël prej 0.21 për qind.

Investime në infrastrukturën shkollore

- Më 21 janar 2025 është vënë gurthemeli për çerdhën e re të Petrovës, me vlerë prej 1,157,656 euro. Ky objekt modern me një sipërfaqe prej 873 metra katrorë është i destinuar për 40 fëmijë. Projekti në fjalë, do të përmirësojë infrastrukturën arsimore dhe krijimin e një mjedisi të sigurt e të përshtatshëm për edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve nga mosha hershme. Aktualisht në këtë institucion kompania kontraktuese është duke punar dhe në tetor të këtij viti do të përurohet.

- Përveç çerdhes, më 21 janar 2025 në Petrovë u vendos edhe gurthemeli për renovimin dhe zgjerimin e shkollës fillore "Bajram Curri," një projekt tjetër madhor me vlerë 1.444.827.85 euro dhe sipërfaqe prej 920 metra katrorë. Aktualisht në objektin e ri kanë përfunduar punimet, ndërsa pas përfundimit të procesit mësimor kanë filluar punimet për renovimin e brendshëm të objektit të vjetër shkollor dhe më 1 shtator objekti në fjalë do të jetë gatshëm për fillimin e vitit të ri shkollor.
- Më **9 shtator 2025** kanë filluar punimet për ndërtimin e sallës sportive në ShFMU "Hasan Prishtina" në Godanc, në vlerë **498.183,81 euro** dhe ende janë duke vazhduar punimet.
- Më **29 tetor 2025** ka filluar renovimi i Gjimnazit "Naim Frashëri" në Shtime në vlerë **797,225.66 euro**. Me punimet që janë duke u kryer, ky institucion shkollor është duke u shndërruar në një objekt modern dhe do të plotëson të gjitha standardet për nevojat e nxënësve dhe të stafit arsimor. Përrurimi i kësaj shkolle do të bëhet po ashtu më 1 shtator.
- Në nëntor 2025 ka filluar ndërtimi i sallës sportive në shkollën e Rashincës dhe Zborcit, në vlerë **372.395,23 euro**. Në sallën e fshatit Zborc, në këtë vit pritet të përfundojnë punimet.
- Më **22 nëntor 2025** ka nisur projekti dyvjeçar në vlerë prej 144 mijë euro për renovimin e institucioneve arsimore duke filluar me nyjet sanitare në ShMU "Emin Duraku" në Shtime, pastaj me këtë projekt është rregulluar edhe kaldaja e shkollës në Mollopolc, suvatimi i një pjese të murit dhe rregullimi i kulmit të shkollës së Carralevës, vendosja e dyerve dhe dritareve të reja në shkollën e Lagjes së Pajtimit, rregullimi i nyjeve sanitare, dyerve, dyshemesë dhe ngjyrosja e mësonjëtove në shkollën e Rashincës si dhe rregullimi i oborrit të shkollës fillore "Emin Duraku" në Shtime.
- Falë përkrahjes së KFOR-it Turk, më **12 janar 2026** është përruruar renovimi i objektit të ShFMU "Bajram Curri", paralelja e ndarë në Mollopolc. Me këtë investim janë vendosur dyert e reja, është lyer komplet hapësira e brendshme, janë rregulluar nyjet sanitare dhe është rregulluar salla e arsimitarëve.
- Më **14 mars 2026** kanë nisur punimet në Renovimin dhe adaptimin e katit përdhese të shkollës së Carralevës dhe shndërrimin e saj në Çerdhe për Fëmijë si dhe punimin e rrethojave të Çerdhës së Muzeqinës. Vlera e përgjithshme është 178.623.20 €. Çerdhja në fjalë ka hapësirë të brendshme: 490 metra katrorë. Kapaciteti i saj është për 40 fëmijë dhe ka gjithsej 3 mësonjëtove, kuzhinën dhe zyrën për stafin administrativ. Në Muzeqinë veçse kanë përfunduar punimet, kurse në Carralevë çerdhja do të përrurohet më 1 shtator të këtij viti. Vlen të përmendet se firma e cila është duke i kryer punimet në çerdhen e fshatit Carralevë, falë vullnetit të mirë ka bërë ngjyrosjen e mureve të mësonjëtove të ciklit të ulët (I – V) si dhe ka instaluar ventilimin për nyjet sanitare të shkollës.

- Më 8 maj 2026 nga Komuna e Shtimes dhe Fondi i Kosovës për Eficiência të Energjisë janë përruar tri objektet shkollore: ShF “Emin Duraku”, IAAP dhe ShFMU “Hasan Prishtina”- Shtime.

Projekti	Vlera e kontraktuar
SHFMU "Hasan Prishtina" - Shtime	€ 300,412.75
SHF "Emin Duraku" - Shtime	€ 292,059.00
Institucioni i Arsimit dhe Aftësimi Profesional - Shtime	€ 352,621.50

Gjithsej: 945,093.25 €

Me këtë projekt janë kryer këto punime: Termoizolimi i mureve të jashtme dhe çatisë, ndërrimi i dritareve dhe dyerve të jashtme, instalimi i ndriçimit LED dhe vendosja e kaldasë me pelet dhe renovimi i rrjetit të ngrohjes.

Investimi në eficiency e energjisë në këto objekte do të na mundësojë jo vetëm kursimin e energjisë dhe reduktimin e kostove operacionale, por edhe përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies për nxënësit dhe mësimdhënësit tanë.

Projekti është financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i cili është implementuar nga Fondi i Kosovës për Eficiency të Energjisë përmes skemës kthyesë për financimin e projekteve komunale.

- Ka rifilluar faza e dytë e rregullimit të rrethojës së shkollës fillore “Emin Duraku” në Shtime dhe ShFMU “Hasan Prishtina” në Godanc.

Regjistrimi i fëmijëve dhe nxënësve në arsimin parauniversitar për vitin shkollor 2026/2027

- Me konkursin publik të shpallur nga Drejtoria Komunale e Arsimit, më 22. 5. 2026 për regjistrimin e fëmijëve në Institucioni Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime (I & II), pastaj në Muzeqinë dhe në Godanc, me rezultatet e shpallura më 8. 6. 2026 nga institucioni në fjalë nga mosha 09 muaj deri në 5-6 vjeç janë regjistruar gjithsej: 111 fëmijë të moshave të ndryshme.

- Nga data 15 maj deri më 15 qershor është bërë regjistrimi i fëmijëve parafillorë dhe nxënësve në klasat e para në 44 paralele.

- Për vitin shkollor 2025/2026, Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Gjinnazin “Naim Frashëri” në Shtime, ka planifikuar shtatë paralele për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X), gjegjësisht në Gjinnazin e Shkencave Shoqërore dhe Natyrore. Po ashtu, DKA në koordinim të plotë me Institucionin e Arsimit dhe Aftësimi Profesional në Shtime ka planifikuar të ketë shtatë paralele në këto profile arsimore: Bashkëpunëtor profesionl i infermierisë, asistent i administratës, kontabilitet, banka dhe sigurime, arkitekturë, informatikë, instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit. Për këtë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2026/2027, ka përgatitur kushtet dhe kriteret e regjistrimit të nxënësve në klasën e (10) në Gjinnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe Aftësimi Profesional (IAAP), ku nga DKA do të shpallet konkursi publik dhe nga data 7, 8 dhe 9 korrik 2026 do të kenë mundësinë nxënësit të aplikojnë për regjistrim.

Përzgjedhja e teksteve shkollore për vitin shkollor 2026/2027

Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime ka pranuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës kërkesën dhe Katalogun e Teksteve Shkollore për klasat I–IX për vitin shkollor 2026/2027, së bashku me lidhjet elektronike të teksteve fituese të shtëpive botuese.

Në bazë të udhëzimeve të MASH-it, katalogu është shpërndarë në të gjitha institucionet arsimore të komunës, ku mësimdhënësit, sipas fushave dhe lëndëve përkatëse, janë angazhuar në shqyrtimin dhe përzgjedhjen e teksteve shkollore nga lista e miratuar.

Pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes nga shkollat, Drejtoria Komunale e Arsimit do të konsolidojë të dhënat dhe do t'ia përcjellë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës katalogun e plotësuar në formë elektronike, brenda afatit të përcaktuar, respektivisht deri më **10 korrik 2026**.

Ky proces synon të sigurojë që institucionet arsimore të pajisen me tekstet e miratuara dhe të përzgjedhura nga vetë mësimdhënësit, në përputhje me nevojat e procesit mësimor dhe procedurat e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Sfidat në arsimin parauniversitar

- Problem në vete kemi Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18. 4. 2017 dhe Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 22. 1. 2021, sipas të cilave parashihen disa përfitime financiare për punonjësit e arsimit, përfshirë pagesën për shujtat ushqimore, shpenzimet e udhëtimit, tri pagat shtesë pas pensionimit, pagat në emër të shpërblimit jubilar, pastaj mjetet financiare për ndryshimet për ngritje profesionale, pagesën e shkallës së inflacionit për çdo vit, pagesën për licencim, pagesën për orët mbi normë për mësimdhënësit klasorë. Duke pasur parasysh implikimet buxhetore të kësaj kontrate, të gjitha komunat e Kosovës kanë probleme financiare në realizimin e investimeve kapitale në shumë projekte komunale meqë detyrohen për t'i shlyer obligimet ndaj mësimdhënësve. Si pasojë e këtyre kontratave të lartpërmendura, vetëm për gjatëmujorin e parë të këtij viti nga buxheti i komunës sonë janë ekzekutuar nga Thesari **401,392.18** euro, ndërkaj në vitin 2025 janë ekzekutuar **605,432.00** dhe për vitin 2024 janë ekzekutuar gjithsej: **868,504.76** euro.
- Sfidë tjetër është rënia e numrit të nxënësve në arsimin parauniversitar që vit pas viti po ndodhë, për shkak të rënies së natalitetit, migrimit fshat-qytet dhe emigrimit jashtë vendit, ku kjo dukuri është më shumë e shfaqur në shkollat e viseve rurale në komuna të ndryshme të vendit tonë. Rënia e numrit të nxënësve sjellë rrezikun për vendet e punës së mësimdhënësve.
- Kemi mungesë të kuadrit profesional në lëndën e matematikës, fizikës, TIK-ut dhe gjuhës gjermane. Kjo dukuri nuk është e shfaqur vetëm në komunën tonë por edhe në komunat tjera.
- Po ashtu kemi kërkesa për rritjen e numrit të asistentëve për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore por aktualisht kemi numrin e kufizuar për rritjen e stafit.